



TE 7
Berat BUZHALA
Drejtor
Prishtinë

Rasti Nr. 2019/33
Ref:1907/940/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2019/33 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për TE 7 (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës përgjegjëse me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 ka iniciuar monitorimin ex officio të raportimit të rastit të njohur si “Gruaja rome” të transmetuar nga data 29 deri më 31 maj 2019. Fokus i monitorimit ishte mënyra e raportimit lidhur me linçimin e gruas rome në rrjetet sociale dhe paraqitja e tij në edicionet e lajmeve dhe informative në Palën përgjegjëse.
3. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 3 qershor 2019 ka gjetur se Pala përgjegjëse gjatë raportimit të kësaj ngjarjeje ka transmetuar video, në të cilat është bërë poshtërimi dhe shkelja e dinjitetit të personit në fjalë, si dhe ka publikuar identitetin e të miturit i cili ka ushtruar dhunë ndaj saj, veprim ky i cili është në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.
4. KPM pas të gjeturave nga monitorimi, me datën 11 qershor 2019 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës. Po ashtu, i ka ofruar mundësinë që

brenda afatit prej tre (3) ditësh, pas pranimit të shkresës, të përgjigjet dhe të ofrojë sqarim në raport me shkeljet e gjetura.

5. KPM me datën 20 qershor 2019 ka pranuar një përgjigje nga Pala përgjegjëse përmes së cilës ata pretendojnë se nuk kanë bërë shkelje dhe janë plotësisht në pajtim me Kodin e Etikës KKPM 2016/03. Transmetimi i kronikës “Gruaja rome” ka qenë të ngrisë vetëdijen për dhunën e ushtruar dhe mungesën e vullnetit ose paaftësinë e organeve të rendit për të parandaluar atë dhunë ndaj saj, njëheritë ata pretendojnë që edhe publikimi dhe identifikimi i të miturit është konform normave të Konventës Ndërkombëtare dhe Direktivave të Parlamentit Europian, ku sipas tyre identiteti i të dyshuarit duhet të zbulohet në rastet kur ekzistojnë shqetësime specifike të sigurisë ku personi në fjalë konsiderohet të jetë i rrezikshëm për qytetarët në përgjithësi.

Analiza ligjore

6. Komisioni i bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 3, paragrafi 3, si dhe të nenit 9, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Neni 3, paragrafi 3, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përcakton se:

“OSHM-të sigurohen që materiali i cili mund të shkaktojë dëme, ose përbën shkelje, të justifikohet nga konteksti. Materialet e tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, gjuhën fyese, dhunën, seksin, dhunën seksuale, poshtërimin, ankthin, shkeljen e dinjitetit njerëzor, trajtimin ose gjuhën diskriminuese. Informacioni i duhur duhet gjithashtu të transmetohet aty ku do të ndihmonte në shmangien apo minimizimin e shkeljes.”

7. Komisioni gjatë monitorimit ka gjetur se Pala përgjegjëse gjatë raportimit të kësaj ngjarjeje ka transmetuar video, në të cilat është bërë poshtërimi dhe shkelja e dinjitetit të personit në fjalë.

Neni 9, paragrafi 1, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përcakton se:

“E drejta e privatësisë së fëmijëve duhet të respektohet gjithmonë. Pasi që publiciteti i panevojshëm apo etiketimi i gabuar mund t'i dëmtojë ata, fëmijët dhe të miturit që janë viktimë të abuzimit apo në konflikt me ligjin nuk duhet të identifikohen drejtpërdrejt apo tërthortë. Nuk duhet të transmetohet asnjë informacion që mund t'i identifikojë ata.”

8. Komisioni gjithashtu në bazë të Raportit të monitorimit ka gjetur se Pala përgjegjëse ka publikuar identitetin e të miturit i cili ka ushtruar dhunë ndaj saj, veprim ky i cili është në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

